

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA AKADEMIA E DREJTËSISË AKADEMIA PRAVDE - ACADEMY OF JUSTICE			
Nr. Org. Jedin. Lnit	01	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	04
faqeve Stranica Pages	1	Data Datum Date	09.01.2019
Prishtinë / a			

Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademia Pravde/Academy of Justice

Nr. 01/ /2018
 Datë: 26/12/2018

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë, në bazë të nenit 11 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, dhe nenit 18 të Rregullores Nr.02/2017 për Punën e Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë, në mbledhjen e katërbëdhjetë të përbërjes së parë të mbajtur më 26 dhjetor 2018, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet procesverbali i takimit të Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë, i mbajtur me datë 26 nëntor 2018.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Aleksandër Lumezi



A. Lumezi

Kryesues i Këshillit Drejtues
 Akademia e Drejtësisë

Vendimi i dërgohet:

Arkivit të Akademisë së Drejtësisë

REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA AKADEMIA E DREJTËSISË AKADEMIJA PRAVDE - ACADEMY OF JUSTICE			
Shënia, Org. Org. Jedin. Org. Unit	01	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	05
Nr. Faqeve Br. Stranica No. Pages	1	Data Datum Date	09.01.2019
Prishtinë / a			




Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice


Nr. 01/ /2018
Datë: 26/12/2018

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë, në bazë të nenit 10 paragrafi 1, nën paragrafi 1.3, dhe nenit 11 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, në mbledhjen e katërbëdhjetë të përbërjes së parë të mbajtur më 26 dhjetor 2018, merr këtë:


V E N D I M

1. Miratohet Plani i Punës i Akademisë së Drejtësisë për vitin 2019.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

Aleksandër Lumezi

Kryesues i Këshillit Drejtues
Akademia e Drejtësisë



Vendimi i dërgohet:
Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë
Arkivit të Akademisë së Drejtësisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Nr. 01/ /2018
Datë: 26/12/2018

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë, në bazë të: nenit 10 paragrafi 1, nën paragrafi 1.4 dhe nenit 25 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, nenit 14 të Rregullores 08/2017 për Trajnuesit dhe mentorët e Akademisë së Drejtësisë dhe nenit 2 të Rregullores 08/2017 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr.06/2017 për Trajnuesit dhe mentorët e Akademisë së Drejtësisë, në mbledhjen e katërmëdhjetë të përbërjes së parë, të mbajtur më 26 dhjetor 2018, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Propozimi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës për mentorët në lëmin penale që do të angazhohen për ti mentoruar gjyqtarët e sapoemëruar në trajnimin fillestar si në vijim:
 - 1.1 Mentor të gjyqtarëve të integruar të sapoemëruar në Gjykatën Themelore në Mitrovicë janë si në vijim:
 - 1.1.1 z. Tomislav Petrović, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, mentor për gjyqtarin Veljko Vučetić;
 - 1.1.2 Radoslav Marković, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, mentor për gjyqtarin Slađan Ribarić;
 - 1.1.3 Lidija Vučurović, gjyqtare në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, mentor për gjyqtaren Slađana Šćepanović;
 - 1.1.4 znj. Branka Semenov, gjyqtare në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, mentor për gjyqtaren Vesna Milić.

1.2 Mentor i gjyqtarit të integruar të sapoemëruar në Gjykatën Themelore në Prishtinë është si në vijim:

1.2.1 z. Agim Kuqi, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, mentor për gjyqtaren Ljiljana Maksimović.

2. Mandati i mentorëve të emëruar përfundon me përfundimin e programit të Trajnimit Fillestar për gjyqtarët e sapoemëruar të integruar si dhe në harmoni me dispozitat e Ligjit për Akademinë e Drejtësisë 05/L-095 dhe Rregulloren Nr.06/2017 për Trajnuesit dhe mentorët e Akademisë së Drejtësisë.
3. Mentorët angazhohen për të zbatuar programin e trajnimit praktik në lëmin penal për periudhën e mbetur të Trajnimit Fillestar.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

Aleksandër Lumezi


Kryesues i Këshillit Drejtues
Akademia e Drejtësisë



Vendimi i dërgohet:
Arkivit të Akademisë së Drejtësisë
Mentorëve të emëruar



REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA AKADEMIA E DREJTËSISË AKADEMIJA PRAVDE - ACADEMY OF JUSTICE			
Njësia, Org. Org. Jedin. Org. Unit	01	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	07
Nr. Faqeve Br. Stranica No. Pages	1	Data Datum Date	09.01.2018



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Nr. 01/ /2018
Datë: 26/12/2018

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë, në bazë të nenit 11 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 05/L-095, për Akademinë e Drejtësisë, dhe nenit 18 të Rregullores Nr.02/2017 për Punën e Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë, në mbledhjen e katërbëdhjetë të përbërjes së parë, të mbajtur më 26 dhjetor 2018, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Rekomandimi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, nën numrin Nr.1 /555 i datës 05.12.2018, për vazhdimin e Trajnimit Fillestar, për gjyqtaret znj. Filloreta Lekiqi dhe znj. Elvira Emimi, të cilat nuk kanë mundur ta përfundojnë Trajnimin Fillestar, për shkak të rrethanave objektive.
2. Gjyqtaret nga pika 1 e këtij vendimit, do ta vazhdojnë pjesën e mbetur të trajnimit duke iu bashkuar gjeneratës së ardhshme të gjyqtarëve të rinj të cilët do ta fillojnë Trajnimin Fillestar pas dekretimit të tyre.
3. Udhëzohet Drejtori Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë që ta përshtat programin e Trajnimit Fillestar të gjeneratës së ardhshme për gjyqtarë, me pjesën e mbetur të trajnimit të gjyqtarëve të cilat nuk kanë mundur ta përfundojnë Trajnimin Fillestar.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Akademia e Drejtësisë ka filluar trajnimin fillestar për gjyqtarët e sapoemëruar - gjenerata e gjashtë me datë 29.09.2017. Pjesë e këtij trajnimi i cili sipas ligjit zgjat 12 muaj, kanë qenë edhe znj. Filloreta Lekiqi dhe znj. Elvira Emimi.

Sipas Vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës Nr. 03/345 të datës 11.05.2018, znj. Elvira Emimi i është lejuar pushimi i lehonisë nga data 02/05/2018, për çka edhe ka ndërprerë vijimin e Trajnimit Fillestar. Ndërsa znj. Filloreta Lekiqi ka ndërprerë Trajnimin Fillestar me datë 23/03/2018 për shkak se ka filluar pushimin e lehonisë sipas vendimit të KGJK me numër Nr.102/2018 të datës 30.03.2018.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës me datë 30.11.2018, ka nxjerrë Rekomandimin me Nr.01/555, me të cilin rekomandohet që Akademia e Drejtësisë, të gjejë mundësinë që për gjyqtaret të cilat nuk kanë mundur të ndjekin Trajnimin Fillestar për gjyqtar deri në fund për shkak të rrethanave objektive, të ju vazhdohet trajnimi për pjesën e mbetur dhe në fund t'i nënshtrihen vlerësimit në pajtim dhe në bazë të rezultateve të treguara gjatë Trajnimit Fillestar.

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë, pas shqyrtimit të Rekomandimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe pas vlerësimit të kostos së lartë financiare që ka organizimi i Trajnimit Fillestar vetëm për dy gjyqtaret që nuk kanë mundur të ndjekin Trajnimin Fillestar për gjyqtar deri në fund për shkak të rrethanave objektive, mori vendim që gjyqtaret znj. Filloreta Lekiqi dhe znj. Elvira Emini, t'i bashkohen trajnimit të gjyqtarëve të gjeneratës së shtatë të gjyqtarëve të cilët do të fillojnë trajnimin pas dekretimit nga Presidenti i Republikës së Kosovës. Organizimi i Trajnimit Fillestar duhet t'i përshtatet, pjesës së mbetur të trajnimit të pa përfunduar nga znj. Lekiqi dhe znj. Emini, në mënyrë që të shkurtohet koha e pritjes së tyre për përfundim të trajnimit.

Bazuar në rekomandimin e Këshillit Gjyqësor dhe dispozitave ligjore në fuqi, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Aleksandër Lumezi

A. Lumezi
Kryesues i Këshillit Drejtues
Akademia e Drejtësisë

Vendimi i dërgohet:
Arkivit të Akademisë së Drejtësisë;
Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
Gjyqtareve të sapoemëruara;